



Procesverbal i Dëgjimeve për
Buxhetin
e vitit 2023 dhe Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB)
2023-2025
në
Salla e Kuvendit

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025, u publikua me datë: 01.08.2022 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: 15.08.2022 deri me datë: 18.08.2022 nën organizimin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Rahovecit, do të organizohen katër (4) dëgjime publike buxhetore, për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendar i dëgjimeve buxhetore për katër (4) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf> më datë: 01.08.2022.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar OJQ-të, Bizneset dhe Grupet e Interesit, Buxhetimi Xhinor ku janë janë të informuar edhe gjinia femerore si dhe Bashkësitë Lokale dhe lagjet urbane përfaqësuesit të shkollave dhe rininë, rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me Bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë u publikua më datë: në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/NJOFTIM-PER-DEGJIM-PUBLIK-ME-FSHATRA-LAGJE-DREJTORE-SHKOLLASH-DHE-RININE.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK NË RAHOVEC

Dëgjimi buxhetor me përfaqësues të Bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 18.08.2022 në Shtëpinë e Kulturës “Mensur Zyberaj”, me fillim në ora **10:00**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga Grupi punes dhe zyrtar komunal ishin: 10

- Femra ishin: 4
- Meshkuj ishin: 6

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 30

- Femra ishin: 29
- Meshkuj ishin: 1

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimin e shpalli të hapur Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z. Afrim Limani.

Afrim Limani: Përsëritje për të gjithë të pranishmit, të nderuar përfaqësues të Bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë, ju të pranishëm. Faleminderit që sot jeni këtu. Jemi sot këtu në dëgjetet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja si Bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2023.

Buxheti për vitin 2023 do të jetë 17,548,240.00 Euro, Paga dhe medijtë në vlerë prej 8,453,088.00 Euro, Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 2,133,829.00 Euro, Shërbime Komunal në vlerë prej 370,000.00 Euro, Subvencione dhe Transfere në vlera prej 820,000.00 Euro si dhe Investimet Kapitale kapin vlerën prej 5,711,323.00 Euro, Mall. Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokoluara si sjellni dhe në Komunë, që më pas të cëdohen nëpër drejtoritë përkatëse. Nëse ka dikush nga kolegët e KPF-së mund të bashkangjiteni, nëse jo urdhëroni ju përfaqësues të Bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë.

1. Besnik Popaj, Fortesë: Të nderuar përsëritje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga janë:

1. Rregullimi I shtratit të lumit

2. Fatmir Sejfullahu, Krushë e Madhe: Të nderuar të pranishëm, përsëritje!

Kërkesat janë:

1. Mungesë e palestres.
2. Mungesë e stadimit për KF Bashkimin

3. Sejfullah Sejfullahu, Krushë e Madhe: Të nderuar të pranishëm, përsëritje!

Kërkesat janë:

1. Mungesë e Palestrës
2. Rregullimi I rrugës së Drinit.
3. Përfundimi I sheshit dhe kubëza.
4. Nevoj për shtëpi muze për Bajram Currin

4. Afrim Krasniqi-Pastasel : Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga Pastaseli janë:

1. Kubëzimi i disa rrugëve
2. Mungesë e ndriçimit në disa lagje
3. Vazhdimi I kanalizimit (dy pjesë) 800m I mbyllur

5. Xhafer Gashi-Sopniq : Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga Sapniq janë:

1. Rregullimi I kanalit të kullimit te perfundoj ne vitin 2022
2. Shkolla të përfshihet ne programin e Eficence

6. Bajram Morina - Vrajak: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga Bajram Morina janë:

1. Rregullimi I rrugës Ratkoc-Vrajak-Brotatin e demtuar

7. Enver Kabashi Zoqisht : Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga Enver Kabashi janë:

1. Rregullimi I rrugicave me kubëza a ka diçka për këte projekt
2. Shkolla të përfshihet ne programin e Eficiencës
3. Vazhdimi I lumit deri te ura e Retisë për shkak të problemeve me vërshime

8. Muhamet Ramadani-Celine: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Muhamet Ramadani** janë:

1. Munges të kanalizimit ne disa lagje të fshatit a ka diçka për vitin 2022

9. Hajredin Kadiri-Rahovec: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Hajredin Kadiri** janë:

1. Sheshi I Rahovecit a do të fillojnë punimet 2022-2023 a është planifiku per viin 2023

11. Beqë Shala-Ratkoc: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Beqë Shala** janë:

1. Vazhdimi I regullimit te rrugeve me kubeza
2. Zgjerimi I kanalizimeve ne disa lagje
3. Zgjerimi I ndriçimit publikë
4. Vazhdimi I perkrahjes se fermereve me mekanizma bujqesor

12. Fadil Bytyqi Xërxe: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Fadil Bytyqi** janë:

1. Ndërtimi I shkolles fillore ne Xërxe
2. Rrezik në hyrje dhe dalje te shkolles
3. Te mirmbahen rrethojat e shkolles
4. Rruga për Satkofc (sinjalizimi)

13. Muharrem Morina-Dejnë: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Muharrem Morina** janë:

1. Intervenime ne kanalizim
2. Rregullimi I fushes se sportit ne oborrin e shkolles
3. Vazhdimi I kodit per festivalin (Anadrinia Jehon) zhveshtore

14. Artan Thaçi-Xërxe: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Artan Thaçi** janë:

1. Sanimi dhe riparimi I rrugeve egzistuse ne fshat
2. Rregullimi I kanalizimit ne lagjen e epërme
3. Gjetja e një parcele prone e komunes për komunitetin e fshatit (varreza)
4. Të zgjerohet ngriqimi public ne disa lagje
5. Të ndertohet nje fushe ndihmese rekreative për femijë
6. Shtrimi dhe mirembajtja e rrugeve fushore (2km)
7. Perfundimi I punimeve ne parkun e fshatit ne rrugen (Skenderbeu)

15. Kujtim Sopjani-Dobidol: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Kujtim Sopjani** janë:

1. Rregullimi i kanalizimit për ujëra të zeza, për te e zgjidhur kete problem duhet te behet lidhja e rrjetit te kanalizimit te vjeter me rrjetin e kanalizim te ri ku është nje gjatesi rreth 400 metra.
2. Rregullimi I kanaleve per ujra atmosferik Brenda ne fshat me gjatesi rreth 750 metra dhe rregullimi nje kanali te kullimit prej hekurudhes deri ne lumen drini I bardhe me gjatesi rreh 1 km
3. Shkolla fillore ne fshatin Dobidol: Rregullimi I rrethojes, oborrit dhe rregullimi I nje fushe te futbollit per nxenes te Shkolles
4. Kubezimi I rrugeve ne fshat me gjatesi rreth 1 km
5. Riparimi I troturareve dhe vazhdimi me kubza deri ne sarosh, me gjatesi rreth 1 km
6. Rregullimi i rrugeve fushore
7. Rregullim i një shteku për ecje në gjatësi rreth 2 km
8. Menagjimi I mbeturinave
9. Rregullim i shtratit të lumit drini i bardhe

16. Artan Asllani-Drenoc: Të nderuar përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat nga **Artan Asllani-Drenoc** janë:

1. Uji i pijes Drenoc-Senoc

Afrim Limani: Faleminderit juve përfaqësues të Bashkësitë lokale dhe lagjet urbane, me përfaqësues të shkollave dhe rininë që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 11:30

Rahovec, 14.9.2022

Ekrem Bytyqi

Kryesues i Grupit Punues